



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 23 Prot.

Tiranë, më 12.01.2026

NJOFTIM

Universiteti i Sporteve të Tiranës, mbështetur në urdhrin nr. 374, datë 14.7. 2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, njofton se:

1. Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, për vitin akademik 2025-2026, që ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve të Tiranës, fillon veprimtarinë akademike në datë 16/02/2026.
2. Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, organizohet si vijon:
 - Kohëzgjatja normale: 1 (një) semestër
 - Numri i krediteve (ECTS): 35
 - Gjuha e realizimit të programit: Shqipe
 - Në përfundim të programit të studimit, lëshohet Certifikatë për formimin psiko-pedagogjik, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
 - Forma e studimit: Me kohë të plotë.
 - Koha e fillimit të programit: Semestri i II (dytë) i vitit akademik 2025/2026.
3. **Afati për aplikimin:** Procedurat e aplikimit për pranimin në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, fillojnë më datë **12/01/2026 dhe përfundojnë më datë 23/01/2026.**
4. **E drejta dhe kërkesat për aplikim:** Në këtë program studimi, kanë të drejtë të aplikojnë dhe të regjistrohen ata kandidatë që kanë fituar diplomë të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe diplomë të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”/ “Master i arteve” ose “Master profesional” me 120 kredite, apo ekuivalente me to, **në një nga fushat e përcaktuara në aneksin 1**, të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlerëshme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar

dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhdueshëm në fushën psiko-pedagogjike”

5. Dokumente të aplikimit dhe forma e aplikimit: Dosja e aplikimit të kandidatit do të përmbajë;

5.1 Kërkesën me shkrim të kandidatit për pranimin në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike të Universitetit të Sportit të Tiranës.

5.2 CV, ku ndër të tjera të pasqyrohet informacioni për institucionet e arsimit të lartë ku kandidati ka fituar diplomat e përcaktuara në pikën 4 të këtij njoftimi si dhe mundësitë e kontaktit (nr. telefoni dhe adresë e mail-i)

5.3 Kopje të noterizuara të diplomave të përcaktuara në pikën 4 të këtij njoftimi.

5.4 Mandat pagesën e tarifës së aplikimit. Fomulari i pagesës së tarifës.

5.5 Dosja e aplikimit do të paraqitet vetëm përmes shërbimit postar, në adresën: Universitetit i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.

6. Tarifat e aplikimit dhe tarifa e regjistrimit:

Bazuar në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.73, datë 17/10/2023 tarifat janë si më poshtë:

6.1 *Tarifa për aplikim është 2500 lekë.* Fomulari i pagesës së tarifës së aplikimi të shkarkohet nga Website i UST.

6.2 *Tarifa për regjistrim është 2000 lekë.*

7. Vendimi për përzgjedhjen e kandidatëve për pranimin në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike të Universitetit të Sportit të Tiranës, do të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në adresën elektronike të kandidatit/ve.

REKTORI

PROF.DR. AGRON KASA

